P14

Fletorja Zyrtare nr. 119/2018 – VKM nr. 480

Ekstrakt: kopertina, vendimi dhe faqet zyrtare 8375–8376 (PDF 1–2 dhe 44–45). Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030; përmend portin intermodal në Shëngjin. Kopja u mor më 06.10.2026 nga arkivi publik në eaglemovement.org/docs/fletorja-zyrtare-e-republikës-së-shqipërisë.pdf. Nuk është leje ndërtimi ose provë më vete e autorësisë.

Kopje për shqyrtim dokumentar. Shënimet e kësaj faqeje janë shpjegime të përgatitura më 06.10.2026 dhe nuk janë pjesë e dokumentit historik.

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 119

Tiranë – E enjte, 9 gusht 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 31.7.2018	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030	8333
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 492, datë 26.7.2018	Për miratimin e mënyrës së rregullimit të aktiviteteve të nismës "Akademia 100 + fshatrat", në zbatim të Programit Kombëtar të zhvillimit rural me fokus 100 + fshatra	8396
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 16.7.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 51, datë 20.9.2013, të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave, "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar", i ndryshuar	8398
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Bahri Toçilla	8401

VENDIM
Nr. 480, datë 31.7.2018

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ENERGJISË PËR PERIUDHËN 2018–2030

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030 rishikohet çdo 3 (tre) vjet.

3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të hartojë planin e veprimit të strategjisë, pjesa II dhe, brenda muajit dhjetor 2018, ta paraqesë për miratim.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Agjencia për Eficiencën e Energjisë, Fondi për Eficiencën e Energjisë, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ndërmarrja publike në aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror "ALBGAZ", ndërmarrja publike në aktivitetet e eksplorimit dhe prodhimit të naftës bruto "Albpetrol", Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHQIPËRIA 2030
STRATEGJIA KOMBËTARE E ENERGJISË
2018–2030
Mars 2018

PARATHËNIE

Të nderuar lexues dhe ekspertë të fushës së energjisë,

Strategjia Kombëtare e Energjisë – Shqipëria 2030, është një moment shumë i veçantë për sektorin energjetik në Shqipëri. Pas një pune intensive, kemi të përfunduar dokumentin më të rëndësishëm për sektorin e energjisë, një udhërrëfyes ky i cili vendos piketat kryesore për modelet e zhvillimit të një prej promotorëve kryesorë të ekonomisë.

Ky dokument vjen sot si rrjedhojë e reformave të guximshme dhe të vështira që ndërmori qeveria shqiptare në sektorin e energjisë elektrike, një reformë të thellë, produktet e së cilës tanimë janë të dukshme.

Rikthimi i ligjshmërisë në konsumin e energjisë elektrike solli rikthimin e besimit të humbur të partnerëve dhe donatorëve të cilët gjithnjë e më shumë po mbështesin projekte investimi. Gjithashtu, investitorët privatë panë një treg energjetik gjithnjë e më likuid që u garanton kthimin e investimit dhe perspektivën e biznesit.

Humbjet e energjisë elektrike janë reduktuar nga 45.04% që ishin më 2013-n në 26.41% në fund të vitit 2017. Rritëm ndjeshëm nivelin e arkëtimeve nga 38.6 miliardë lekë më 2013-n në 64.1 miliardë lekë në fund të vitit 2017.

Hoqëm barrën e rëndë të sektorit energjetik nga buxheti i shtetit duke i kthyer tri kompanitë publike në kontributore të stabilitetit fiskal. Në këto vite, OSHEE-ja, KESH-i dhe OST-ja kanë derdhur në tatim-taksa një shumë prej 45.5 miliardë lekësh.

Gjatë këtyre viteve, vetëm në sektorin e shpërndarjes është arritur të investohen 160 milionë euro në gjithë Shqipërinë. Në transmetim arritëm të përfundojmë linjën e interkonjeksionit elektroenergjetik 400 kV të Shqipërisë me Kosovën, duke vendosur edhe themelet e bashkë-punimit dhe krijimit të një burse të përbashkët për sektorin elektroenergjetik. Përfunduam edhe linjën 110 kV të Unazës së Jugut, ndërsa po fillojmë ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV mes Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Ligji nr. 116/2016 "Mbi performancën e energjisë së në ndërtesa"	Direktiva 2010/31/ BE mbi performancën e energjisë në ndërtesa	I përafruar pjesërisht me direktivën 2010/31/BE mbi performancën energjetike në ndërtesa, ligji u miratua nga parlamenti në nëntor 2016 dhe hyri në fuqi në fillim të vitit 2017. Masa e kërkuar: → Është i rëndësishëm krijimi i Agjencisë së EE-së të parashikuar nga ligji për eficiencën e energjisë nr. 124/2015, sepse kjo agjenci do të verifikojë dhe mbikëqyrë zbatimin e performancës energjetike në ndërtesa ; → Krijimi i Fondit EE për të mbështetur masat e eficiencës së energjisë.
Ligji nr. 68/2012 "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji"	Direktiva 2010/30/ BE mbi etiketimin e energjisë	Ligji ende nuk është në përputhje me etiketimin e pajisjeve elektro-energjetike krahasuar me aktet e deleguara të BE-së. Më tej, legjislacioni dytësor për etiketimin e pajisjeve elektro-energjetike është ende në proces. Aktualisht, të vetmet akte nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji janë: - VKM nr. 65, datë 21.10.2015 "Për rregullat teknike për etiketimin e konsumit të energjisë nga kondicionerët"; - VKM nr. 928, datë 19.12.2012 "Për miratimin e rregullit teknik "Për etiketimin e makinave larëse për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë".

Harmonizimi i politikës shqiptare për ndryshimet klimatike me direktivat ndërkombëtare dhe të BE-së

Shqipëria është palë nënshkruese e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), e miratuar në "Samitin e Tokës në Rio" në vitin 1992, i cili vendosi objektivin për të luftuar ndryshimet klimatike duke stabilizuar përqendrimet e GHG-së në atmosferë dhe duke kufizuar rritjet mesatare të temperaturës globale për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Marrëveshja e Parisit, e miratuar në dhjetor 2015, siguron një kuadër të përbashkët për të gjitha palët që synojnë ruajtjen e rritjes së temperaturës mesatare globale nën 2°C mbi nivelet para-industriale. Për arritjen e një qëllimi të tillë afatgjatë, palët duhet të synojnë arritjen e pikut të nivelit global të emetimeve të GHG-ve "sa më shpejt që të jetë e mundur", duke pranuar se rritja do të zgjasë më shumë për palët e vendeve në zhvillim dhe për të ndërmarrë, më pas, reduktime të shpejta në përputhje me praktikat shkencore më të mira në dispozicion, për të arritur një ekuilibër midis emetimeve prej aktiviteteve njerëzore nga burimet dhe eliminimeve nëpërmjet përthithjes nga shtimi dhe rritja e pyjeve

Bazuar në skenarin bazë të emetimeve të GHG dhe në Komunikimin e Tretë Kombëtar nevojat energjetike në sektorin e transportit do të rriten në të njëjtin ritëm që po rriten që nga viti 2000. Masat e mundshme për rritjen e efikasitetit të energjisë, nën skenarin EE dhe reduktimin e shkarkimeve të GHG, janë si më poshtë:

- Zbatimi i objektivave të EE-së për sektorët e transportit të Shqipërisë, bazuar në PKVEE 2 dhe 3 të miratuar;
- Zbatimi i objektivave të BRE-së për sektorët e transportit (sidomos rritja e kontributit të biokarburanteve që do të konsumohen në këtë sektor sipas objektivave përkatës) të Shqipërisë në bazë të PKVBRE-së;
- Rindërtimi i rrugëve ekzistuese të cilësisë së dobët dhe ndërtimi i rrugëve të reja;
- Mirëmbajtja e rrugëve përmes bashkë-punimit të sektorit publik me atë privat;
- Rritja e pjesës së transportit publik për pasagjerët dhe transportin e mallrave (rrugë, hekurudhë dhe rrugë ujore);
- Rritja e taksave për makinat e kategorisë së dytë për të reduktuar në maksimum hyrjen e tyre në tregun shqiptar;
- Promovimi i një sistemi të integruar të transportit intermodal, i cili përfshin infrastruk-turën/transportin përmes tokës dhe detit;
- Ristrukturimi i mëtejshëm i sistemit hekurudhor, krijimi i Autoritetit Hekurudhor Shqiptar, riorganizimi i Hekurudhave Shqiptare, nëpërmjet ndarjes së plotë të aktiviteteve operative nga aktivitetet e menaxhimit dhe mirëmbajtja e infrastrukturës;
- Intensifikimi i punës për krijimin e një sistemi të integruar të transportit, i fokusuar në lidhjen e porteve të Durrësit, Vlorës dhe Shëngjinit me linjë hekurudhore;

- Ndërtimi i një porti intermodal në Shëngjin, i cili do të jetë një nga portet më të mëdha në rajon dhe do të shërbejë si pikë lidhëse midis detit Adriatik dhe vendeve të tjera në Ballkanin qendror dhe lindor;

- Ndërtimi i porteve të reja turistike, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme dhe logjistikën moderne për këtë qëllim;

- Hapja e tregut dhe ulja e kostos së tarifave të udhëtimit për udhëtarët, me qëllim të rritjes së lëvizjes së udhëtarëve dhe mallrave;

- Promovimi i investimeve të bazuara në partneritetin publik-privat për qëllime të turizmit vendës;

- Ndërtimi i një aeroporti të ri në jug të vendit (Vlorë);

- Rritja e bashkëpunimit rajonal në fushën e transportit ajror;

- Të mundësohet një performancë më e mirë e funksioneve të sigurisë ajrore, si dhe forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike në këtë sektor.

Marrëveshja e Parisit synon, gjithashtu, të forcojë aftësinë për t'iu përshtatur ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm, dhe me shkarkime të ulëta të dyoksidit të karbonit nëpërmjet financimit të teknologjive të EE-së dhe BRE-së. Mbështetja për vendet në zhvillim duhet të ofrohet nga vendet e zhvilluara, në lidhje me zbutjen dhe përshtatjen, duke vazhduar synimin e përbashkët për të mobilizuar 100 miliardë dollarë në vit deri në vitin 2025, kur do të vendoset një objektiv i ri i përbashkët.

Në mënyrë që të arrihen objektivat e uljes së shkarkimeve, Marrëveshja krijon një sistem "analitik të komponentëve individualë", ku Palët do të duhet të përgatisin dhe komunikojnë Kontribute Kombëtare të Pikësynuara (KKP) çdo pesë vjet, me qëllim përmirësimin progresiv të përpjekjeve të tyre.

Përveç KKP-së, palët duhet të formulojnë strategjitë afatgjata të zhvillimit me nivele të ulëta të shkarkimit të gazeve serrë deri në mesin e shekullit, dhe t'i paraqesin deri në vitin 2020 strategjitë përkatëse, të cilat tregojnë mënyrën sesi përpjekjet e tyre do të kontribuojnë në qëllimin e shkarkimeve zero deri në gjysmën e dytë të këtij shekulli.

Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Parisit, më 22 prill 2016 dhe marrëveshja do të hyjë në fuqi pasi 55 vende që përbëjnë të paktën 55% të emetimeve globale, të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit.

BE-ja miratoi "Udhërrëfyesin[10] për ekonominë me shkarkime të ulëta të GHG", më 2011-n, duke përcaktuar një rrugë me kosto efektive për të bërë ekonominë evropiane më të favorshme ndaj klimës dhe që konsumon më pak energji. Udhërrëfyesi sugjeron që deri në vitin 2050, BE duhet të zvogëlojë shkarkimet e saj në 80% nën nivelet e vitit 1990. Pikat kryesore për të arritur këtë janë ulja e shkarkimeve me 40% deri më 2030-n dhe me 60% deri në vitin 2040. Të gjithë sektorët duhet të kontribuojnë në kalimin në ekonomi me shkarkime të ulëta të GHG, sipas potencialit të tyre teknologjik dhe ekonomik. Udhërrëfyesi i BE për ekonominë me shkarkime të ulëta të GHG kërkon veprim në të gjithë sektorët ekonomikë kryesorë, përgjegjës për nivelin e shkarkimeve të Evropës - prodhimi i energjisë elektrike dhe termike, industria, transporti, sektori rezidencial, shërbimet dhe bujqësia – dhe më specifikisht duhet të bëhen investime të rëndësishme, në:

- Teknologji të reja me shkarkime të ulëta të GHG-së;

- Burimet e rinovueshme të energjisë;

- Eficiencën e energjisë; dhe

- Përmirësime të ndjeshme në infrastrukturën e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Shqipëria ka filluar procesin e ndryshimit të statusit nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar, në kontekstin e UNFCCC-së. Ky proces është pjesë integrale e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të gazeve serë (GHG), formulimin dhe zbatimin e politikave për reduktimin e GHG-së dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, transpozimin dhe zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian për ndryshimet klimatike. Në përputhje me objektivat e BE-së 20–20–20, Shqipëria ka vendosur objektiva sasiorë në lidhje me

[10] COM(2011) 112 final/2. E disponueshme ne: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:5db26ecc-ba4e-4de2-ae08-dba649109d18.0002.03/DOC_2&format=PDF